

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Numri i lëndës: **P. Kr. Nr. 282/2014; PPS 45/2012**

Data: **4 shkurt 2015**

[Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm]

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it **Jennifer SEEL**, si kryetare trupit gjykues, gjyqtarja e Republikës së Kosovës **Valbona Musliu-Selimaj**, dhe gjyqtarja e EULEX-it **Marie Tuma**, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e këshilltarit ligjor të EULEX-it Valon Hasanit, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër:

1. B.D.

Emri dhe mbiemri:	B.D.
Emri i babait:	XXX
Profesioni:	Bujk
Data e lindjes:	XXX
Vendi i lindjes:	Abri, Komuna e Drenasit
Vendbanimi:	XXX
Kombësia dhe shtetësia:	Shqiptar i Kosovës
Numri i identifikimit:	XXX
Statusi familjar:	I martuar; katër fëmijë

2. H.T.

Emri dhe mbiemri:	H.T.
Emri i babait:	XXX
Profesioni:	I papunësuar

Data e lindjes:	XXX
Vendi i lindjes:	Burojë, Komuna e Skenderajt
Vendbanimi:	XXX
Kombësia dhe shtetësia:	Shqiptar i Kosovës
Numri i identifikimit:	XXX
Statusi familjar:	I martuar; dy djem

Që të dy të akuzuar sipas Aktakuzës së prokurorit publik P Kr. Nr. 282/14, të datës 19 maj 2014 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës Themelore të Prishtinës më 21 maj 2014 për veprën në vijim:

- 1. USHTRIM I NDIKIMIT**, duke kërkuar, marrë ose pranuar një ofertë ose premtim të një përparësie të padrejtë për vete ose për personin tjetër në lidhje me ushtrimin e një ndikimi të paduhur nga ana e kryerësit mbi vendimmarrjen e një personi zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, në kundërshtim me nenin 345, paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës (2004) (në tekstin e mëtejme i referuar si “KPPK”), e dënueshme me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

Dhe pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, të hapura për publik, më 29 dhe 30 tetor 2014, 04, 11, 12, 25 dhe 26 nëntor 2014, 17 dhjetor 2014, 20 dhe 21 janar 2015 si dhe më 2 shkurt 2015 dhe pas shpalljes së aktgjyqimit më 04 shkurt 2015; që të gjitha në prani të të pandehurve B.D. dhe H.T.; e me kërkesë të të pandehurve edhe në prani të avokatëve të tyre përkatës mbrojtës XXX dhe XXX apo zëvendësuesve të tyre; dhe prokurorit publik të EULEX-it Andrew Carney, pas shqyrtimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 2 shkurt 2015, në pajtim me nenin 359 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme të referuar si “KPP”), shpalli publikisht dhe në prani të të pandehurve, avokatëve të tyre mbrojtës dhe prokurorit publik Andrew Carney, dhe mori këtë:

AKTGJYKIM

- Të akuzuarit, **B.D.** dhe **H.T.**, me të dhënat personale të cekura më lart,

Secili prej tyre sipas Pikës 1 të Aktakuzës janë

FAJTOR

Sepse ishte dëshmuar përtej dyshimit të bazuar se në përdhën ndërmjet prillit të viti 2009 dhe qershorit të vitit 2009, dy të pandehurit kanë kërkuar dhe kanë marrë shumën prej 200.000 Euro nga

një grup prej pesë personave në këmbim të ushtrimit të ndikimit mbi zyrtarët vendimmarrës nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm "AKP") në lidhje me një ofertë të paraqitur në një tender të privatizimit.

Pas shpalljes së valës së 34^{-të} të privatizimit nga AKP-ja më 14 prill 2009, 5 personat e lartpërmendur, më saktësisht S.Z., Z.B., I.M., B.K. dhe A.J. ishin pajtuar që të blejnë 91 hektarë tokë në fshatin Muzakaj në komunën e Obiliqit. Para dorëzimit të tenderit për blerjen e tokës, të pandehurit dhe së paku katër nga pjesëtarët e grupit, më saktësisht S.Z., Z.B., I.M. dhe B.K. kishin arritur një marrëveshje, me anë të së cilës të pandehurit do të ushtronin ndikimin e tyre në AKP për të siguruar se oferta për blerje të tokës në emër të B.K. do të ishte e suksesshme. Sipas kësaj marrëveshje të pandehurve do t'iu paguheshin së paku 200.000 Euro para të gatshme.

Më 20 maj 2009, B.K. kishte paraqitur një ofertë në shumën prej një milion e gjysmë Euro për 91 hektarë tokë të referuar më lartë. Kjo ofertë kishte qenë e suksesshme. Shuma e dakorduar në iu ishte paguar të pandehurve me kërkesë të tyre. Në këtë mënyrë të pandehurit kishin pranuar shumën prej 200.000 Euro më dy këste. Kësti i parë prej së paku 120.000 Euro para të gatshme iu ishte dorëzuar të pandehurve nga S.Z. dhe Z.B. gjatë një takimi në restorantin Druri në fund të majit të vitit 2009. Kësti i dytë ishte paguar rreth një javë më vonë.

Prandaj, të pandehurit B.D. dhe H.T., me të dhënat personale si më sipër, kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale të **USHTRIM I NDIKIMIT**, në kundërshtim me nenin 345, paragrafi 1, lexuar së bashku me Nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (2004).

II. I pandehuri **B.D.**:

DËNOHET

Me një (1) vit e tre (3) muaj burgim sipas Pikës 1 – ushtrim i ndikimit;

I pandehuri **H.T.**:

DËNOHET

Me një (1) vit e tre (3) muaj burgim sipas Pikës 1 – ushtrim i ndikimit;

III. Të pandehurit **B.D.** dhe **H.T.** janë të obliguar që së bashku dhe veçmas të paguajnë shumën prej 200.000 Euro si kompensim për konfiskimin e shumës gjegjëse prej 200.000 Euro të përvetësuar me anë të kryerjes së veprës penale.

Të pandehurve iu lejohet që këtë shumë ta paguajnë me këste prej 10.000 Euro për 20 muaj.

- IV. Secilin nga të pandehurit duhet të paguajë shumën prej njëqindpesëdhjetë Euro (150) si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa lirohen nga obligimi për të kompensuar bilancin e shpenzimeve të procedurës në pajtim me nenin 453, paragrafin 1, 3 dhe 4 të KPPK-së.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES:

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES:

Gjyqtarja e EULEX-it
Jennifer Seel

Gjyqtarja Valbona Musliu-
Selimaj

Gjyqtarja e EULEX-it
Marie Tuma

PROCESMBAJTËSI

Zyrtari Ligjor i EULEX-it
David Hegarty

KËSHILLË JURIDIKE:- I pandehuri, përfaqësuesi i tyre ligjor, prokuror apo i dëmtuari mund të paraqesin ankesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dorëzimi i këtij aktgjykimi në përputhje me nenin 380 paragrafin 1 dhe nenin 381 paragrafin 1 të KPPK-së. Ankesa duhet të parashtrohet në gjykatën e shkallës së parë sipas nenit 388, paragrafi 1 i KPPK-së.